



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:204227  
Datë: 22.03.2024  
Numri i dokumentit: 05489151

Ac.nr.656/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, kundër të paditurit E.P, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.293/12, të datës 24.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 21.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

APROVOHET e themeltë ankesa e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.293/12 e datës 24.11.2020 dhe gjykohet si në vijim: Aprovohet kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit si e bazuar dhe Detyrohet i padituri E.P, që paditësit t'ia kompensoj shumën prej 3,707.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar të dëmtuarit në aksidentin e datës 01/10/2008, me kamat siç paguajnë bankat afariste në Kosovë, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padis me 25/06/2012 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.293/15 e datës 17/11/2020, ka vendosur më sa vijon:

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit SI E BAZUAR dhe DETYROHET i padituri E.P që paditëses t'ia kompensoj me ndarje të përgjegjësisë prej 70% përgjegjës i padituri dhe 30% paditësja nga shuma e përgjithshme prej 3.707.00 euro, që t'ia paguaj paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit shumën prej 2594.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 01.10.2008 në Podujevë rr."Zahir Pajaziti", palës së dëmtuar - lëndime trupore këmbësorit I.B nga Podujeva, me kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste të Kosovës, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 40 euro.

II. Shumën e rimbursimit të dëmit dhe shpenzimet e procedurës i padituri detyrohet t'ia paguaj paditëses në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. Përtej shumës së aprovuar prej 2.594.00 euro, shuma tjetër e kërkuar prej 1.113.00 euro refuzohet si e pa bazuar në bazë të përgjegjësisë prej 70% për të paditurin dhe 30% të palës paditëse.

Kundër pjesës refuzuese të aktgjykimit, paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 201 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve, me datën 25.06.2012, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurit, për shkak të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 01.10.2008, me arsye sikurse në padi.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka filluar procedurën dhe pas marrjes së përgjigjes në padi, vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka marrë aktgjykimin e ankimuar me përmbajtje sikurse në dispozitivin e tij. Në arsyetim ka cekur se në bazë të, ekspertizës së komunikacionit, procesverbaleve në çështjen kontestimore të udhëhequr me numër 26/2009 dhe urdhërtransferi dhe raporti i transferit ka vërtetuar se shkaktar i aksidentit me lëshime primare është i padituri E.P, ndërsa e dëmtuara ka pasur lëshime sekondare, pra në rastin konkret kemi përgjegjësi të ndarë në shaktimin e aksidentin. Dëmin e shkaktuar nga aksidenti të dëmtuarës I.B BKS-ja ia ka kompensuar në shumë prej 3.707.00 Euro e vërtetuar përmes Urdhërtransferit të BKS-ës dhe raportit të transferimit të parave, dëm ky i cili është caktuar në Pajtimin Gjyqësor që ka arritur tani paditësja BKS me të dëmtuarin në procedurën kontestimore. Gjykata ka vlerësuar se kemi të bëjmë me ndarje të përgjegjësisë së shkaktimit të dëmit ndërmjet të paditurit dhe të dëmtuarës pasi të dyja palët, tani i padituri dhe e dëmtuari kanë marrë pjesë së bashku në shkaktimin e dëmit paditësja BKS ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e dëmit nga i padituri në bazë të përgjegjësisë dhe kontributit të tij në shaktimin e aksidentit 70% me 30 %. Gjykata ka çmuar se kërkesëpadija e paditëses përkitazi me lartësinë e pretenduar pjesërisht ka themelësinë në prova materiale, përkatësisht në raportin policor, ekspertizën e komunikacionit, , urdhërtransferi, andaj për këto arsye i padituri është pjesërisht përgjegjës për të rimbursuar këtë dëm që paditësja ka qenë e detyruar fillimisht ta paguaj ndaj personave që ka pësuar dëme nga aksidenti i shkaktuar nga i padituri dhe rrejdhimisht për pasojë të kësaj, i padituri ka detyrimin që këtë shumë t`ia rimbursion paditëses, ndërsa refuzimin e pjesës tjetër të kërkesëpadiës së paditëses e ka arsyetuar me faktin se edhe e dëmtuara ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit. Me rastin e vendosjes gjykata është bazuar në Rregullin 3, 4, 4.6 dhe 4.9 të BQK-së, neneve 17.1, 262.1 dhe nenin 277 të Ligjit mbi Marrëdhënieve të Detyrimeve dhe neneve 449, 452 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, nuk është zbatuar drejt e drejta materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit, pas shikimit dhe vlerësimit me kujdes të shtuar të shkresave të lëndës, i rezultoi se gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes, nuk i ka shqyrtuar të gjitha provat materiale siç parashihet me nenin 8 të LPK-së dhe si rezultat e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, për arsye se nga marrëveshja gjyqësore C.nr.26/2009 e datës 23/06/2009 e lidhur në Gjykatën Komunale në Podujevë, vërtetohet në mënyrë bindëse se paditësja me të dëmtuarin janë dakorduar për ndarjen e përgjegjësisë në shkaktimin e aksidentit dhe atë në shkallë prej 20 % dhe mbi bazën e kësaj ndarje të përgjegjësisë është arritur pajtimi që vlera e kompensimit të dëmit të jetë 3,372.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 335.00 euro apo gjithsejtë 3707.00 euro, të cilën kompensim paditësja ia ka përmbushur të dëmtuarit dhe kjo vërtetohet përmes urdhër transferit të datës 24/06/2009. Gjykata e shkallës së parë edhe përkundër asaj se paditësja e ka bërë ndarjen e përgjegjësisë me të dëmtuarin me rastin e arritjes së pajtimit gjyqësor, e njëjta serish bënë ndarje të përgjegjësisë në shkaktimin e aksidentit dhe atë 70 % për të paditurin dhe 30 % për të dëmtuarin dhe mbi bazën e kësaj e zvogëlon edhe pagesën që paditësja ia ka kompensuar të dëmtuarit e që realisht bënë barazim të përgjegjësisë në shkaktimin e aksidentit në mes të paditurit dhe këmbësorit-të dëmtuarit e i cili përfundim është në kundërshtim edhe me ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti Y.K i cili në mendimin dhe konstatimin e tij përfundimtar, në mënyrë bindëse i ka përshkruar lëshimet e të paditurit i cili e ka drejtuar automjetin me shpejtësi me të madhe se të lejuar në vendbanim urban, ku kufizimi i shpejtësisë ishte 40 km/h, ndërsa ka vozitur me shpejtësi prej 66.30 km/h si dhe i padituri nuk ka treguar kujdes të shtuar ndaj këmbësorit i cili ka qenë i moshuar dhe veç kishte hyrë në rrugë për të kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë, duke mos e përshtatur shpejtësinë me frenim dhe ngadalësim me kohë e që sipas ekspertizës rezulton se i padituri është shkaktari kryesor i këtij aksidenti i cili ka drejtuar automjetin pa regjistrim dhe pa sigurim, ndërsa lëshimet e të dëmtuarit janë sekondare, për shkak se kalimin e rrugës e ka bërë në vendin ku nuk ka shenja për vendkalim të këmbësorëve dhe nuk e ka pasur kujdesin e duhur e që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit rezulton se kontributi i të paditurit në shkaktimin e aksidentit është në shkallë prej 80 %, ndërsa kontributi i të dëmtuari është në shkallë prej 20 %. Sipas nenit 18 par.1 i përcakton se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*, par.4 i këtij neni përcakton se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”*.

Vendim mbi kamatën është bazuar në nenin 277 të LMD-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 pika b) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:204227  
Datë: 22.03.2024  
Numri i dokumentit: 05489151

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
Ac.nr.656/21, me datë 21.03.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku